

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës :

Inspektor Rajonal në Vlorë -AKEP

Në rast se një vend vakant, në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore, apo organi kompetent, për institucionet e pavarura, ka marrë vendim, në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, atëherë, në procedurën e ngritjes në detyrë kanë të drejtë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

Procedura : **NGRITJE NE DETYRE / PRANIM NGA JASHT SHËRBIMIT CIVIL**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Në zbatim të Kreut V, Neni 26, pika 4 të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe Kreut III të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) njofton se pas vlerësimit paraprak të kandidatëve:

- **Z. Enri RISTA** do të vazhdojnë konkurimin për pozicionin **Inspektor Rajonal në Vlorë**.

Konkurimi

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e QKMF të AKEP(salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, Nr.43, mbrapa bar restorant la voglia, në datën **21.02.2017** ora **10:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e QKMF të AKEP(salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, Nr.43, mbrapa bar restorant la voglia, në datën **21.02.2017** ora **13:00**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Ngritjes në Detyre në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- b) **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c) **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **“Inspektor Rajonal në Vlorë”**

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **22.02.2017**.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **23.02.2017**.

Njesia Përgjegjëse

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)